

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË
P-352/2007
8 shkurt 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË me Trupin Gjykes të përbërë nga gjykatësi nga EULEX Caroline Charpentier në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykes dhe gjykatësve nga EULEX Hajnalka-Veronika Karpati dhe Jonathan Welford-Carroll si anëtarë të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor nga EULEX Francesco de Sanctis si proces-mbajtës në lëndën penale kundër:

Ymer Krasniqit kundër të cilit është ngritur aktakuzë më 27 dhjetor 2007 dhe konfirmuar më 23 dhjetor 2009, me akuzë të vrasjes sipas nenit 146 dhe pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paligjshëm të armëve sipas nenit 328, paragrafi 2, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), në paraburgim që nga data 1 tetor 2007 deri më 7 shkurt 2011.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, të hapura për publikun më 7 dhe 8 shkurt 2011 në prani të të akuzuarit Ymer Krasniqi, avokatit të tij mbrojtës Nexhat Beqiri dhe Prokurorit Publik nga EULEX Adebayo Kareem, pleqërimit të Trupit Gjykes dhe votimit të mbajtur më 8 shkurt 2011, në pajtim me nenin 392, paragrafi (1), KPPK, u shqiptua hapur dhe në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit Publik nga EULEX, si në vijim

AKTGJYKIM

A.

Akuza për vrasje sipas nenit 146, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) kundër Ymer Krasniqit, e

[REDACTED]


[REDACTED] në paraburgim që nga 1 tetor 2007 deri më 7 shkurt 2011 **refuzohet** sipas nenit 389, pika 1, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

- **për shkak** se më 8 shkurt 2011 gjatë seancës së shqyrtimit kryesor prokuroria ka tërhequr akuzën kundër **Ymer Krasniqit**

Name:
Job Number: 1547

Translated by: SC Phone:

Page: 1 of 7



B.

Ymer Krasniqi me kaq

SHPALLET FAJTOR

Ngase më 1 tetor 2007 në fshatin Stanovc të Ulët, komuna e Vushtrrisë ishte në posedim të armës, revolverit TT-M-57, kalibri 7.62 mm, pa leje të vlefshme armëmbajtjeje.

Me të bërë këtë, i akuzuari Ymer Krasniqi ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të

Pronësisë, kontrollit, posedimit dhe përdorimit të paligjshëm të armës në kundërshtim me nenin 328, paragrafi (2), Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK).

Prandaj, i akuzuari **Ymer Krasniqi** me kaq

DËNOHET

Me 1 (një) vit burgim për veprën penale të Pronësisë, kontrollit, posedimit apo përdorimit të paligjshëm të armës.

Koha e kaluar në paraburgim nga 1 tetor 2007 deri më 7 shkurt 2011 llogaritet në dënim në pajtim me nenin 73, paragrafi (1), KPPK.

Revolveri TT-M-57, kalibri 7.62 mm me kaq konfiskohet në pajtim me nenin 328, paragrafi (5), KPPK.

Në pajtim me nenin 102, para. 4, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i akuzuari lirohet nga detyra për të paguar shpenzimet.

ARSYETIMI


A. Prapavija procedurale

Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë në aktakuzën PP.nr. 299/07, të datës 27 dhjetor 2007 akuzon Ymer Krasniqin me vrasje në kundërshtim me nenin 146, Kodi i

Name:
Job Number: 1547

Translated by: SC Phone:

Page: 2 of 7



Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) dhe pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paligjshëm të armës në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, KPPK.

Aktakuza është konfirmuar më 23 dhjetor 2009. Gjykatësit nga EULEX morrën lëndën më 2 dhjetor 2010.

Seancat e shqyrtimit kryesor janë mbajtur më 7 dhe 8 shkurt 2011. Prokurori nga EULEX Adebayo Kareem, Avokati Mbrojtës Nexhat Beqiri dhe i pandehuri Ymer Krasniqi ishin të pranishëm përderisa pala e dëmtuar Mustafe Krasniqi, babai i viktimës edhe pse i ftuar zyrtarisht më 8 shkurt, nuk ishte i pranishëm në shqyrtim kryesor. Fjalët përfundimtare të Prokurorit nga EULEX Adebayo Kareem, Avokatit Mbrojtës Nexhat Beqiri dhe ajo e të pandehurit Ymer Krasniqi u dëgjuan më 8 shkurt 2011. Vendimi është dhënë verbalisht që ditën e njëjtë.

B. Kompetenca e gjykatës

Sipas nenit 23, pika 1 i), KPPK, gjykatat e qarkut kanë kompetencë për të gjykuar lëndët penale që kanë të bëjnë me akuza për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej së paku pesë vjetëve. Në pajtim me nenin 27, paragrafi (1), KPPK, juridiksioni territorial i takon gjykatës në qarkun ku pretendohet të jetë kryer vepra penale.

I akuzuari ngarkohet me veprat penale të vrasjes sipas nenit 146, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), që lejon shqiptimin e dënimit penal prej së paku pesë vjetëve burgim dhe Pronësisë, kontrollit, posedimit dhe përdorimit të paligjshëm të armës sipas nenit 328, paragrafi 2, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), që lejon shqiptimin e dënimit me gjobë deri në 7 500 Euro apo dënim prej një deri në tetë vjetë burgim. Aktakuza pretendon se i akuzuari ka kryer veprën penale në fshatin Stanovc të Ulët, komuna e Vushtrrisë, e cila gjendet në qarkun e Mitrovicës.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organi kompetent për të trajtuar këtë procedurë penale.

C. Kualifikimi ligjor – ligji i zbatueshëm


Veprat penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të armës datojnë 1 tetor 2007. Në atë kohë, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili hyri në fuqi më 6 prill 2004, ishte ligji i zbatueshëm. Në pajtim me nenin 2, paragrafi (1), Kodi i Përkohshëm Penal, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së krimit do të zbatohet kundër kryerësit. Ligji nuk ka pësuar ndonjë ndryshim në favor të të akuzuarit para shpalljes së këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 2, paragrafi (2), KPPK.

Prandaj, Gjykata i është referuar dispozitave të KPPK-së si ligji i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës.

Name:
Job Number: 1547

Translated by: SC Phone:

Page: 3 of 7



D. Provat

1. Provat e paraqitura gjatë procedurës

Më 8 shkurt 2011, Lufti Raci, ekspert balistik u dëgjua në cilësinë e dëshmitarit ekspert.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 8 shkurt 2011, i akuzuari Ymer Krasniqi ka dhënë deklaratë.

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, Prokurori Publik nga EULEX paraqiti dokumentet e përmendura më poshtë si prova:

(1) Raporti i identifikimit nga forensika (raport hetimor), i datës 02.10.2007.

Raporti përshkruan se si policia vajti në shtëpinë e të pandehurit, e bastisi atë dhe konfiskoi pistoletën TT M-57 7,62 mm dhe një karikator me 5 fishekë të kalibrit 7,62 x 25 mm, pa shtënë.

(2) Lista e gjësendeve të konfiskuara (1 pistoletë TT M-57 7,62 mm dhe 1 karikator me 5 fishekë të kalibrit 7,62 x 25 mm, pa shtënë), e datës 01.10.2007.

2. Pranueshmëria e provave

Raporti i policisë i datës 2 tetor 2007 dhe lista e gjësendeve të konfiskuara të datës 1 tetor 2007 rezultuan nga bastisja e shtëpisë në pronën e të pandehurit nga ana e policisë më 1 tetor 2007. Çështja e pranueshmërisë së provave në fjalë u ngrit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor sepse Trupi Gjykses ishte i mendimit se policia nuk ndoqi procedurën e rregullt për bastisje të shtëpisë, procedurë e paraprakë me kod.

Neni 240, KPPK, parasheh gjykatësin e procedurës paraprakë të autorizojë bastisjen e shtëpisë apo neni 245 (1), KPPK, kushtet që lejojnë policinë të futet në shtëpi pa urdhrin e gjykatësit të procedurës paraprakë “ (...) nëse është e nevojshme dhe në masë të nevojshme”.

Dosja e lëndës nuk përmban ndonjë vendim nga gjykatësi i procedurës paraprakë për autorizimin e veprimit të tillë hetimor. Mirëpo, duke pasur parasysh seriozitetin e veprës penale dhe kornizën kohore të hetimit në këtë rast të veçant, Trupi Gjykses është i mendimit se policia ka vepruar në pajtim me nenin 245, KPPK. Sidoqoftë, nga dosja e lëndës duket se janë shkelur dispozitat e nenit 245 (3) dhe (6), KPPK, ngase është dashur së paku të jepet një urdher verbal nga gjykatësi i procedurës paraprakë apo nga prokurori dhe policia është dashur t'i raportojë me shkrim njëerës nga këto dy palë pas bastisjes.

Për të gjitha arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses është i mendimit se policia ka bastisur shtëpinë e të pandehurit në mënyrë të paligjshme dhe me kaq raport identifikues i forenzikës, i datës 02.10.2007 shpallet i papranueshëm sipas nenit 246, paragrafi (6), KPPK.

Si pasojë e shpalljes së raportit të lartpërmendur si të papranueshëm, lista e gjësendeve të konfiskuara gjithashtu duhet të deklarohet e papranueshme ngase bastisja e paligjshme e shtëpisë solli deri te konfiskimi i paligjshëm i gjësendeve. Dëshmitë e palëve gjatë shqyrtimit kryesor mbesin prova të pranueshme.

E. Kryerja e krimit dhe përgjegjësia penale

1. Sa i përket akuzës së vrasjes sipas nenit 146, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK)

Gjatë seancës së shqyrtimit publik më 8 shkurt 2011, Prokurori Publik nga EULEX tërhoqi akuzën për vrasje kundër Ymer Krasniqit pas dëshmisë së Lufti Racit, ekspert balistik i ftuar si dëshmitar.

Prandaj, sipas nenit 389, pika 1), KPPK, Trupi Gjykses refuzoi pikën e akuzës për vrasje.

2. Sa i përket pikës së akuzës për pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paligjshëm të armëve sipas nenit 328, paragrafi 2, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK)

Aktakuza PP.nr. 299/07 e datës 27 dhjetor 2007 ngarkon të akuzuarin Ymer Krasniqi për pronësi, kontrollë, posedim apo përdorim të paligjshëm të armëve ngase pretendohet se më 1 tetor 2007 në fshatin Stanovc të Ulët, komuna e Vushtrrisë, ai është gjetur në posedim të një arme, respektivisht revolver TT-M-57, kalibri 7.62 mm pa leje për armëmbajtje.

Pavarësisht nga fakti se në një të anë provat e paraqitura nga Prokurori Publik nga EULEX gjatë shqyrtimit kryesor u shpallën të papranueshme nga Trupi Gjykses, në anën tjetër Trupi Gjykses e sheh si të rëndësishme të marrë parasysh deklaratën e dhënë nga i pandehuri gjatë shqyrtimit kryesor kur në mënyrë nënkuptuese e pranoi se ka qenë në posedim të armës në fjalë duke thënë “nuk kisha ndërmend t’i bëja kujt gjë të keqe, unë ndihmova policinë ta gjente”. Deklarata e tij gjatë shqyrtimit kryesor nënkupton se ai ishte në pronësi të kësaj arme, respektivisht pistoletën TT-M-57, kalibri 7.62 mm në shtëpinë e tij. Për më tepër, ishte vetë ai që i tregoi policisë vendin specifik se ku është gjetur ajo. Përfundimisht, ai nuk solli dokumentet për të vërtetuar se ka leje për të mbajtur këtë armë.


Prandaj, i akuzuari shpallet fajtor për posedim të paligjshëm të armës.

F. Përcaktimi i dënimit

Name:
Job Number: 1547

Translated by: SC Phone:

Page: 5 of 7



Për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit, Trupi Gjykses duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues në pajtim me nenin 64, paragrafi (1), KPPK. Trupi Gjykses konsideroi si rrethanë lehtësuese faktin se i pandehuri ka pranuar të ketë qenë në posedim të armës dhe se bashkëpunoi me policinë për të gjetur atë. Ky rast nukj përmban ndonjë rrethanë rënduese.

Për veprën penale të pronësisë, kontrollës, posedimit apo përdorimit të paligjshëm të armës sipas nenit 328, paragrafi 2, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), ligji parasheh dënimin me gjobë deri në 7500 Euro apo burgim prej një deri në tetë vjetë.

Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e përmendura më lart, Trupi Gjykses gjeti se dënimi me burgim prej një viti është adekuat në përmbushjen e qëllimit të dënimit sipas nenit 34, KPPK.

G. Konfiskimi

Në pajtim me nenin 328, paragrafi (5), KPPK, Trupi Gjykses urdhëron konfiskimin e pistoletës së marrë, TT-M-57, kalibri 7.62 mm dhe të karikatorit të konfiskuar me 5 fishekë të kalibrit 7,62x25mm.

H. Shpenzimet

Trupi Gjykses shpalli fajtor të akuzuarin Ymer Krasniqi për veprën penale të pronësisë, kontrollës, posedimit apo përdorimit të paligjshëm të armës sipas nenit 328, paragrafi 2, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK).

Mirëpo, në pajtim me nenin 102, paragrafi 4, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Ymer Krasniqi lirohet krejtësisht nga detyra e mbulimit të shpenzimeve.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P. nr. 352/2007

Përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Zyrtar Ligjor


Francesco de Sanctis

Name:
Job Number: 1547

Kryetar i Trupit Gjykses
Caroline Charpentier

Translated by: Phone:
SC

Page: 6 of 7



Mjet ligjor:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim në Gjykatën Supreme të Kosovës nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të këtij akt-gjykimi në pajtim me nenin 398, paragrafi (1), KPPK.

Name:
Job Number: 1547

Translated by: SC Phone:

Page: 7 of 7

